



OPINIONI I PESTË PËR SHQIPËRINË

KOMITETI KËSHILLIMOR PËR KONVENTËN KUADËR PËR MBROJTJEN E PAKICAVE KOMBËTARE

Miraturar më 6 qershor 2023

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

ACFC/OP/V(2022) 1

19/10/2023

Secretariat of the Framework Convention for the Protection of National Minorities
(Sekretariati i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare)
Council of Europe (Këshilli i Evropës)
F-67075 Strasbourg Cedex
France

www.coe.int/minorities

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJA E KONKLIZIONEVE	4
Vetëidentifikimi i lirë	4
Censi	Error! Bookmark not defined.
Situata e personave që u përkasin pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane	4
Të drejtat gjuhësore	5
Pjesëmarrja politike	5
REKOMANDIME	6
Rekomandime për veprim të menjëhershëm	6
Rekomandime të mëtejshme	6
Vazhdimi i këtyre rekomandimeve	7
PROCEDURA E MONITORIMIT	8
Aktivitetet vijuese lidhur me rekomandimet e Opinionit të Katërt të Komitetit Këshillimor	8
Përgatitja e raportit shtetëror për ciklin e pestë	8
Vizitë në vend dhe miratimi i Opinionit të Pestë	8

PËRMBLEDHJA E KONKLUZIONEVE

1. Atmosfera për personat që i përkasin pakicave kombëtare në Shqipëri karakterizohet nga respekti i ndërsjellë dhe dialogu ndërkulturor, veçanërisht nga toleranca ndërfetare. Megjithatë, mungesa e përgjithshme e pothuajse çdo të dhëne të besueshme ose të zbërthyer, në lidhje me situatën e pakicave kombëtare- që nga censi e deri tek gjuha e urrejtjes ose krimi i urrejtjes- e bën të vështirë vlerësimin me siguri të kësaj, dhe për autoritetet hartimin e masave të posacme për të adresuar nevojat dhe interesat e personave që u përkasin pakicave kombëtare. Kuadri ligjor në fuqi është i qëndrueshëm, por i përgjithshëm në natyrën e tij. Prandaj, problematike mbetet miratimi ende i parealizuar i akteve qëndrore nënligjore, sikurse edhe përmbajtja e këtij kuadri nënligjor në drejtim të pengimit të zbatimit praktik të Ligjit për Pakicat Kombëtare dhe Konventës Kuadër. Institucionet kundër diskriminimit respektohen mirë dhe vazhdojnë të mbrojnë të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare.

2. Shqipëria përballet me një sërë sfidash, ndër më të dukshmet emigracioni në Evropën Perëndimore dhe migrimi i brendshëm drejt kryeqytetit. Trafikimi i qenieve njerëzore është gjithashtu shqetësim aktual, me një ndikim të veçantë tek pakicat kombëtare. Këto dukuri kanë një ndikim të veçantë tek ata që jetojnë në zona të thella, ku shkalla e varfërisë është më e lartë. Rritja e shpejtë e industrisë së turizmit po sjell gjithashtu një rizhvillim në pjesë të mëdha të vendit, por në veçanti të bregdetit, dhe nxitimi për të ndërtuar po prek aftësinë e personave që i përkasin pakicave kombëtare për të ruajtur dhe zhvilluar kulturat e tyre minoritare si edhe për të marrë pjesë në mënyrë efektive në jetën ekonomike dhe sociale të vendit, duke i shtyrë ata nga zonat e banuara tradicionalisht prej tyre.

3. Shqipëria është gjithashtu kapur midis marrëdhënieve të ndërlikuara ndërshtetërore dhe procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, të cilat kontribuojnë në shtresat e marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe që kanë një ndikim të veçantë tek personat që u përkasin pakicave kombëtare. Në të vërtetë, masa e përfshirjes në Shqipëri e shteteve fqinje dhe shteteve të tjera të interesuara në dhënie e fondeve dhe mbështetjeve të tjera për “minoritetet e afërta” çon në mungesën e pritshmërisë nga ana e personave që u përkasin pakicave kombëtare që qeveria shqiptare do të ofrojë mbështetje për ta, duke i nxitur ata të kërkojnë zgjidhje praktike për të siguruar mbështetje për kulturat dhe gjuhët e tyre të pakicave jashtë vendit. Kjo më pas ushqen një dyshim pabesie ndaj grupeve të pakicave kombëtare nga ana e autoriteteve shqiptare.

Vetëidentifikimi i lirë

4. Nuk është miratuar ende akti nënligjor për mbledhjen e të dhënave, i cili përcakton rregullimet për identifikimin zyrtarisht si të tillë të personave që u përkasin pakicave kombëtare. Projektakti që është parë nga Komiteti Këshillimor propozon të

mbështetet në ato që konsiderohen kritere objektive bazuar në dokumentacionin zyrtar, që është problematike për shkak të varësisë nga mbledhja famëkeqe jo e besueshme historike e të dhënave në lidhje me pakicat kombëtare në Shqipëri. Në çdo rast, kjo nuk është në përputhje me Konventën Kuadër, pasi kritere të tilla objektive nuk janë parashikuar në Konventë – përkundrazi, shënjesit e identitetit si gjuha, feja, kultura ose traditat, të përfshira në Konventën Kuadër dhe Ligjin Shqiptar për Pakicat Kombëtare, duhet të ofrojnë një bazë të mjaftueshme për qëllime të vetëidentifikimit të lirë. Në vend të përdorimit të dokumentacionit si një faktor vendimtar në njohjen e një individi si pjesë e një pakice kombëtare, në një rishikim të projektaktit nënligjor autoritetet duhet t'i japin peshë vendimtare zgjedhjes subjektive të individit që ai të trajtohet si pjesë e një pakice kombëtare.

Censi

5. Censi ishte planifikuar të realizohej gjatë 2020 dhe 2021, dhe duhet të bëhet (në kohën e miratimit të këtij opinioni) përfundimisht në tetor 2023. Në Ligjin e Censit janë bërë ndryshime për të hequr gjokat administrative në rastin e dhënies së përgjigjeve 'të gabuara', dhe përgjigjet me të vërtetë nuk do të kontrollohen në gjendjen civile. Ky është një zhvillim pozitiv. Megjithatë, Komiteti Këshillimor thekson rëndësinë e këtij censi dhe qasjes së tij pjesëmarrëse për të siguruar një bazë të dhënash, mbi të cilat autoritetet duhet të vazhdojnë të hartojnë dhe zbatojnë politika të synuara, me kusht që personat që i përkasin pakicave kombëtare të jenë plotësisht të informuar dhe të kenë besim në procesin e censit.

Situata e personave që u përkasin pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane

6. Ndërkohë që pakicat rome dhe egjiptiane njihen në Ligjin për Pakicat Kombëtare si pakica të veçanta kombëtare, dokumentet e politikave të autoriteteve tentojnë t'i ngatërrojnë dy pakicat së bashku. Plani i Veprimit, për shembull, është hartuar për pakicat rome dhe egjiptiane, edhe pse përfaqësuesit e tyre deklarojnë se ata përballen me çështje të ngjashme në shtrirje të ndryshme, ose në të vërtetë pjesërisht me çështje të ndryshme. Prandaj, nevojiten të dhëna të ndara për të vlerësuar dhe adresuar nevojat e dy pakicave.

7. Segregimi në shkollë është një problem sistemik në të gjithë Shqipërinë dhe një rast i diskriminimit në një shkollë ka qenë objekt i një vendimi të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Komiteti Këshillimor e vizitoi këtë shkollë dhe dëgjoi drejtpërdrejt nga shkolla për sfidat me të cilat përballet administrata e menaxhimit të shkollës. Ekziston një vullnet i qartë i autoriteteve për ta trajtuar këtë problem, por nevojitet një qasje më e koordinuar dhe sistematike për t'i dhënë fund segregimit në mënyrë efektive në shkollat përkatëse.

8. Situata e strehimit të pakicave rome dhe egjiptiane është shqetësuese, duke përfshirë

natyrën segreguese, e cila kontribuon në problemet në shkollat e segreguara. Kjo është gjithashtu rezultat i diskriminimit të përhapur në tregun privat të qirave, aksesit të pamjaftueshëm në banesat dhe skemat e subvencionimit të qirasë, statusit të parregullt të pronës ku jetojnë personat që u përkasin këtyre pakicave, si dhe rezultat i kërcënimit dhe realitetit në lidhje me dëbimet me forcë. Siguria e banesave duke pasur parasysh në veçanti kërcënimet mjedisore ngre shqetësime serioze. Diskriminimi në tregun e punës gjithashtu ndikon negativisht tek personat që i përkasin minoriteteve romë dhe egjiptiane. Aksesit në kujdesin shëndetësor për personat, veçanërisht gratë, që u përkasin pakicave romë dhe egjiptiane është gjithashtu shqetësues, përsëri me diskriminimin që raportohet si faktor në kontaktet me profesionistët e kujdesit shëndetësor, por gjithashtu edhe aksesit në qendrat shëndetësore dhe klinikat, një shqetësim i raportuar për ata që jetojnë në vende të thella ose në komunitete të izoluar. Boshllëqet në mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi, përfshirë trafikimin dhe abuzimin janë shqetësuese.

Të drejtat gjuhësore

9. Një mori të drejtash gjuhësore kushtëzohen nga pragjet: 20% e popullsisë së një bashkie duhet të jetë deklaruar se i përket një pakice kombëtare. Pavarësisht kërkesave të Komitetit Këshillimor për qartësi, mbetet e paqartë nëse kjo do të llogaritet në bazë të censit apo procesit të vetëidentifikimit të përshkruar më sipër.

10. Kjo situatë krijon shqetësime të shumta. Ekziston një mungesë e plotë e të dhënave të besueshme për madhësinë numerike të grupeve të pakicave kombëtare, gjë që ngre pikëpyetje se si do të llogaritet dhe si do të zbatohet në praktikë një prag prej 20%. Duke pasur parasysh madhësinë e bashkive në Shqipëri, ndër më të mëdhatë në rajon, dhe reformën e bashkive të vitit 2014, për të cilat përfaqësuesit e pakicave vazhdojnë të pretendojnë

se kufizojnë në mënyrë disproporcionale të drejtat e tyre, mund të jetë e pamundur për pakicat kombëtare, veçanërisht ato numerikisht më të vogla, ose ato të shpërndara gjeografikisht në të gjithë Shqipërinë, për të aksesuar në mënyrë efektive të drejtat e tyre të pakicave. Prandaj, Komiteti Këshillimor është në favor të një qasjeje më të diferencuar, e cila do të siguronte akses në të drejtat e pakicave në një nivel më lokal sesa në atë të bashkisë (kjo mund të bëhet veçanërisht për sinjalistikën rrugore), në fshatrat ku jetojnë pakicat kombëtare. Fatkeqësisht, në situatën aktuale qasja në të drejtat e pakicave mbetet de facto e kufizuar në tri bashki, dhe me një bashki tjetër që tani ofron arsim në gjuhët e pakicave.

Pjesëmarrja politike

11. Personat që u përkasin pakicave kombëtare kanë pak mundësi të marrin pjesë në vendimmarrje në nivel kombëtar, domethënë në parlament. Në nivel lokal, ka përfaqësues të pakicave në bashkitë ku grekët dhe maqedonasit përbëjnë shumicën absolute të banorëve. Personat që i përkasin pakicave romë dhe egjiptiane mungojnë në nivel kombëtar të vendimmarrjes, megjithëse janë disa përfaqësues në nivel lokal.

12. Komiteti për Pakicat Kombëtare është ndërtuar për të shërbyer si zëri i pakicave brenda qeverisë. Megjithatë, personat që u përkasin pakicave kombëtare shpesh e shohin atë si zërin e qeverisë brenda pakicave. Ky karakterizim buron pjesërisht ajo që perceptohet si mungesë ndikimi për 20 vite nga ana e personave që i përkasin pakicave kombëtare, nga fakti që kryetari dhe zëvendësi emërohen nga Kryeministri dhe një hezitim institucional për të modifikuar procedurat ose për të përkrahur në mënyrë efektive personat që u përkasin të drejtave të pakicave kombëtare. Si zëri i vetëm i pranishëm vazhdimisht për pakicat kombëtare në nivel kombëtar, Komiteti Këshillimor shpreson që Komiteti mund të përshtatet, duke pasur parasysh ndryshimet e bëra në funksionimin e tij, dhe të ndjekë në mënyrë efektive mandatin e tij.

REKOMANDIME

13. Komiteti Këshillimor konsideron se vërejtjet përmblylëse të paraqitura dhe rekomandimet mund të shërbejnë si bazë për rezolutën që do të miratohet nga Komiteti i Ministrave në lidhje me zbatimin e Konventës Kuadër nga Shqipëria.

14. Autoritetet ftohen të marrin parasysh qëndrimet dhe rekomandimet e hollësishme të përfshira në këtë Opinion të Komitetit Këshillimor. Në veçanti, ata duhet të marrin parasysh masat e mëposhtme për të përmirësuar më tej zbatimin e Konventës Kuadër:

Rekomandime për veprim të menjëhershëm

15. Komiteti Këshillimor u kërkon autoriteteve të sigurojnë që legjislacioni dytësor që përcakton kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare të miratohet pa vonesa të mëtejshme. Ky legjislacion duhet të respektojë në mënyrë rigorozë parimin e vetëidentifikimit të lirë, siç parashikohet në nenin 3 të Konventës Kuadër, duke parashikuar mundësinë e deklaramit të përkatësive të shumfishta, me synimin për të siguruar akses efektiv në të drejtat e pakicave për personat që u përkasin pakicave kombëtare. Autoritetet duhet t'i japin peshë vendimtare zgjedhjes subjektive të individit për t'u trajtuar si pjesë e një pakice kombëtare në vend të atyre që konsiderohen si kritere objektive bazuar në dokumentacionin zyrtar.

16. Komiteti Këshillimor u kërkon autoriteteve të ndërmarrin përpjekje konkrete dhe të qëndrueshme me personat që u përkasin pakicave kombëtare për të krijuar besim në procesin e censit, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e censit, mundësitë për vetëidentifikim të lirë, duke përfshirë përkatësinë e shumfishtë, dhe dispozitat e ligjit të ri të censit. Krahas kësaj, autoritetet duhet të sigurojnë rekrutimin dhe trajnimin e intervistuesve të censit që u përkasin pakicave kombëtare, dhe që të gjithë intervistuesit të jenë të trajnuar siç duhet, duke përfshirë mbështetjen e personave analfabetë.

17. Komiteti Këshillimor u kërkon autoriteteve të ndërmarrin veprime të vendosura për të integruar ato shkolla të prekura realisht nga segregimi dhe për të parandaluar përsëritjen e segregimit, duke nxitur shkolla të tilla të punojnë ngushtë me të tjerë për të ofruar arsim cilësor gjithëpërfshirës në klasa, brenda programit mësimor.

18. Komiteti Këshillimor u kërkon sërish autoriteteve të vlerësojnë nivelin e kërkesës për arsimin në gjuhën e pakicave, dhe mbi këtë bazë, të garantojnë akses efektiv në arsimin në gjuhën e pakicave për personat që u përkasin pakicave kombëtare që e kërkojnë këtë në të gjithë vendin dhe në të gjitha nivelet. Kjo duhet të paraprihet nga fushata ndërgjegjësuese për të siguruar që personat që u përkasin pakicave kombëtare janë mjaftueshëm të vetëdijshëm për të drejtat e tyre.

Zbatimi i pragut prej 20% të pranisë në një bashki duhet të rishikohet dhe nëse është e nevojshme të ulet ose të ndryshohet fusha territoriale e aplikimit, për të siguruar akses efektiv në arsimin në gjuhën e pakicave.

19. Komiteti Këshillimor u kërkon autoriteteve të sigurojnë qasje në strehim të mjaftueshëm për romët, veçanërisht përmes sigurimit të investimeve për garantimin e aksesit në ujë të pijshëm dhe energji elektrike në zonat ku jetojnë romët. Autoritetet duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë garantimit të kushteve të sigurt të jetesës, gjithashtu duke pasur parasysh rreziqet që vijnë nga ndotja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, si dhe sigurisë ligjore të kohëqëndrimit. Në këtë kontekst, rregullimi i pronësisë të pronave që zotërohen ose janë të banuara nga persona që i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane është veçanërisht i rëndësishëm. Autoritetet publike të interesuara duhet të respektojnë detyrimet për të raportuar çdo dëbim të planifikuar pranë Avokatit të Popullit dhe për të ofruar strehim të përshtatshëm alternativ, dhe nëse këto detyrime nuk përmbushen duhet të zbatohen sanksione.

Rekomandime të mëtejshme¹

20. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të zhvillojnë mënyra dhe mjete për të mbledhur të dhëna për barazinë në lidhje me personat që u përkasin pakicave kombëtare, veçanërisht pakicat rome dhe egjiptiane, dhe veçanërisht në fushën e arsimit, strehimit, punësimit dhe kujdesit shëndetësor, në përputhje me standardet evropiane për mbrojtjen e të dhënave. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të vazhdojnë punën për të reduktuar rrezikun e pashtetësisë tek personat që u përkasin pakicave kombëtare. Autoritetet duhet të marrin një rol më aktiv në hetimin dhe trajtimin e ndikimit të martesave fiktive, veçanërisht tek gratë dhe fëmijët që u përkasin pakicave kombëtare, duke përfshirë dhënien e mbështetjes së nevojshme sociale, ligjore dhe financiare për to, të sigurojnë që e drejta martesore zbatohet siç duhet në mënyrë jodiskriminuese dhe të rrisin ndërgjegjësimin për rreziqet e këtij procesi tek personat që i përkasin pakicave kombëtare.

21. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve që të mbrojnë në mënyrë efektive të drejtën e personave që i përkasin pakicës kombëtare greke për të ruajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre në zonat e vendbanimeve të tyre tradicionale, veçanërisht duke ofruar mbrojtje efektive nga praktikat e zhvillimit urban që janë të dëmshme për aftësinë e tyre të vazhdueshme për të banuar në këto zona, dhe duke siguruar që të drejtat e tyre pronësore respektohen plotësisht.

22. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të rrisin ndërgjegjësimin për mbrojtjen ligjore nga gjuha e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes, dhe për mjetet juridike të disponueshme për ata që janë më të ekspozuar ndaj këtyre formave të armiqësisë.

¹ Rekomandimet e mëposhtme janë vendosur sipas renditjes së neneve përkatëse të Konventës Kuadër.

Autoritetet gjithashtu duhet të mbledhin sistematikisht të dhëna të ndara sipas, *ndër të tjera*, përkatësisë së pakicave, mbi gjuhën e urrëjtjes dhe krimin e urrëjtjes, dhe të hartojnë si përgjigje masa parandaluese të dedikuara. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve që të mbledhin sistematikisht të dhëna për trafikimin dhe format e tjera të dhunës ndaj fëmijëve dhe grave, të ndara sipas përkatësisë minoritare, dhe të zhvillojnë politika dhe masa gjithëpërfshirëse për të parandaluar dhe luftuar këto forma të dhunës. Për këtë qëllim, autoritetet duhet të angazhohen ngushtësisht me shërbimet sociale dhe ato ligjzbatuese, si dhe me personat që u përkasin pakicave kombëtare, duke përfshirë fëmijët dhe gratë. Ato gjithashtu duhet të synojnë ofrimin e mbështetjes së nevojshme, qoftë nëpërmjet kujdesit social apo masave të tjera, për ata që janë në situata vulnerabiliteti, dhe në veçanti të synojnë të forcojnë besimin ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe institucioneve, veçanërisht shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

23. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve që të miratojnë menjëherë legjislacionin nënligjor për përdorimin e gjuhëve të pakicave me autoritetet publike. Ky legjislacion duhet të parashikojë një qasje të përshtatshme ndaj pragut të 20% dhe t'i kushtojë vëmendjen e duhur personave që u përkasin pakicave kombëtare që kanë banuar tradicionalisht në zona të caktuara, me qëllim që të garantojë që të drejtat e pakicave gëzohen në mënyrë efektive në praktikë dhe në përputhje me nenin 10 të Konventës Kuadër.

24. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të sigurojnë praninë dhe kontributin kulturor të pakicave kombëtare dhe personave që u përkasin atyre, duke përfshirë gratë, në tekstet shkollore dhe materialet e tjera arsimore të përdorura në të gjitha shkollat, duke siguruar ndërkohë që një përmbajtje e tillë pasqyron me saktësi historinë e Shqipërisë dhe pakicat e saj dhe nuk rrezikon të ndezë tensionet ndëretnike.

25. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të krijojnë një sistem të ndarë të mbledhjes së të dhënave, duke u përqendruar veçanërisht në çdo dallim gjinor në lidhje me frekuentimet, braktisjet e shkollës ose rezultatet, si dhe shkaqet e mundshme për çdo dallim të identifikuar. Autoritetet duhet të hartojnë masa për t'i trajtuar menjëherë këto çështje në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e pakicave. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të caktojnë ndërmjetësues arsimorë romë dhe egjiptianë që punojnë me nxënës që i përkasin pakicave romë dhe egjiptiane, për të punuar së bashku me psikologët e shkollave, punonjësit socialë dhe mësuesit për të rritur shkallën e frekuentimit dhe për të punuar që të parandalojnë braktisjen e shkollës, duke përfshirë

promovimin e vlerave të arsimit. Autoritetet duhet të sigurojnë që ndërmjetësuesit e tillë të marrin trajnim gjatë shërbimit, siguri kontraktuale dhe pagë të mjaftueshme.

26. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të sigurojnë trajnim të përshtatshëm për mësuesit e gjuhëve të pakicave dhe të përmirësojnë cilësinë dhe afatet kohore të ofrimit të materialeve cilësore arsimore të pakicave. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të zhvillojnë trajnimin e mësuesve dhe materialet edukative për arsimin në gjuhën romë dhe ta integrojnë këtë arsim në programin mësimor. Gjithashtu duhet bërë punë e mëtejshme për zhvillimin e arsimit universitar dhe kërkimit mbi gjuhën romë dhe vllahe në Shqipëri, me mbështetjen e autoriteteve.

27. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të rishikojnë procedurat e emërimit për drejtimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare për të siguruar pavarësinë e tij. Ata gjithashtu duhet të zhvillojnë rregulla të sakta procedurale për t'i mundësuar atij të kryejë me efikasitet dhe efektivitet mandatin e tij. Vëmendje e mëtejshme duhet t'i kushtohet gjithashtu diversitetit të anëtarësisë për sa i përket gjinisë dhe moshës, dhe për të siguruar që ai reflekton diversitetin e opinionëve brenda pakicave.

28. Komiteti Këshillimor u bën thirrje autoriteteve të shtojnë përpjekjet e tyre për të ofruar akses efektiv në shërbimet e kujdesit shëndetësor për personat që u përkasin pakicave romë dhe egjiptiane, duke përfshirë shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues. Ata gjithashtu duhet të sigurojnë trajnime për profesionistët e kujdesit shëndetësor për shmangien e anticiganizmit, dhe të eksplorojnë mënyra për të ofruar kujdes shëndetësor për personat pa dokumentacion përkatës, ose të ofrojnë mënyra për të aksesuar një dokumentacion të tillë pa kosto.

29. Komiteti Këshillimor u bën thirrje sërish autoriteteve që të rishikojnë, në konsultim me përfaqësuesit e pakicave kombëtare, ndikimin e reformës administrative dhe territoriale të vitit 2014 mbi aksesin në të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe të korrigjojnë çdo mangësi të identifikuar.

Vazhdimi i këtyre rekomandimeve

30. Komiteti Këshillimor i inkurajon autoritetet që të organizojnë një takim vijues pas publikimit të këtij opinioni të ciklit të pestë. Ai konsideron se një dialog vijues për të shqyrtuar vëzhgimet dhe rekomandimet e bëra në këtë opinion do të ishte i dobishëm. Për më tepër, Komiteti Këshillimor është i gatshëm të mbështesë autoritetet në identifikimin e mënyrave më efikase për zbatimin e rekomandimeve të përfshira në këtë opinion.

PROCEDURA E MONITORIMIT

Aktivitetet vijuese lidhur me rekomandimet e Opinioni të Katërt të Komitetit Këshillimor

31. Opinioni i Katërt i Komitetit Këshillimor, i miratuar në vitin 2018, nuk u botua në asnjë faqe interneti qeveritare, dhe as nuk u përkthye në shqip ose në ndonjë gjuhë të pakicave kombëtare. Nuk u zhvillua asnjë tryezë e rrumbullakët për të ndjekur rekomandimet e Opinioni të Katërt të Komitetit Këshillimor.

Përgatitja e raportit shtetëror për ciklin e pestë

32. Raporti shtetëror është marrë më 5 maj 2021.² Komiteti Kombëtar i Pakicave Kombëtare kontribuoi në përgatitjen e tij. Në raport janë trajtuar disa aspekte gjinore të drejtave të pakicave.

Vizitë në vend dhe miratimi i Opinioni të Pestë

33. Ky Opinion i ciklit të pestë mbi zbatimin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (më tej “Konventa Kuadër”) nga Shqipëria u miratua në përputhje me nenin 26(1) të Konventës Kuadër dhe rregullën 25 të Rezolutës (2019) 49 të Komitetit të Ministrave. Përfundimet bazohen në informacionin që përmban raporti i pestë i shtetit, në burime të tjera të shkruara, si dhe në informacione të marra nga Komiteti Këshillimor nga burime qeveritare dhe joqeveritare gjatë vizitës së tij në Korçë, Fier, Dropull, Sarandë dhe Tiranë nga data 14 deri më 18 nëntor 2022. Komiteti Këshillimor shpreh mirënjohjen e tij ndaj autoriteteve për

bashkëpunimin e tyre para, gjatë dhe pas vizitës, si dhe ndaj personave të tjerë me të cilët u takuan gjatë vizitës për kontributet e tyre të vlefshme. Projekt-opinioni, i miratuar nga Komiteti Këshillimor më 16 shkurt 2023, i'u transmetua autoriteteve shqiptare më 21 shkurt 2023 për komente, sipas rregullës 37 të Rezolutës (2019)49. Komiteti Këshillimor mirëpriti komentet e dwrguara nga autoritetet shqiptare më 28 prill 2023.

* * *

34. Një numër nenes të Konventës Kuadër nuk mbulohen në këtë opinion. Duke u bazuar në informacionin që disponon aktualisht, Komiteti Këshillimor vlerëson se zbatimi i këtyre neneve nuk ngre ndonjë çështje për koment specifik. Kjo deklaratë nuk duhet kuptuar si sinjalizim se tashmë janë marrë masat e mjaftueshme dhe se përpjekjet në këtë drejtim mund të pakësohen apo edhe të ndërpriten. Përkundrazi, Komiteti Këshillimor konsideron se detyrimet e Konventës Kuadër kërkojnë një përpjekje të vazhdueshme nga autoritetet. Për më tepër, një gjendje e caktuar e punëve që mund të konsiderohet e pranueshme në këtë fazë mund të mos jetë domosdoshmërisht e tillë në ciklet e mëtejshme të monitorimit. Së fundi, mundet që çështjet që në këtë fazë duken si shqetësime relativisht të vogla, me kalimin e kohës mund të dëshmojnë se janë nënvlerësuar.

² Raporti shtetëror i paraqitur nga Shqipëria, marrë më 5 maj 2021, është i disponueshëm në anglisht në: <https://rm.coe.int/5th-sr-albania-en/1680a2614c> dhe në shqip në: <https://rm.coe.int/5th-sr-albania-al/1680a2614d>.

Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është një organ i pavarur që ndihmon Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës në vlerësimin e përshtatshmërisë të masave të marra nga palët në Konventën Kuadër për të zbatuar parimet e përcaktuara aty.

Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 10 nëntor 1994, e cila ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 1998, përcakton parimet që duhen respektuar, si dhe synimet që duhen arritur nga shtetet për të garantuar mbrojtjen e pakicave kombëtare. Përveç shumë gjuhëve të tjera, teksti i Konventës Kuadër është i disponueshëm edhe në gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare, greke, maqedonase, malazeze, romë dhe serbe.

Ky opinion përmban vlerësimin e Komitetit Këshillimor pas vizitës së tij të 5-të në Shqipëri.

www.coe.int/minorities

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut.

Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë aderuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE